



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 73

Prishtinë, më 28.3.2014, në orën 11:15

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Skender Hyseni, Sabri Hamiti, Berat Buzhala, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi dhe Hamza Balje.

Mungoi: Enis Kervan.

Pjesëmarrës të tjerë: Albana Merja-GLPS dhe Doruntina Gashi, praktikante.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Edvald Qerimi, praktikant.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i d i t ë s:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26 shkurt 2014;
3. Mbikëqyrja zbatimit të Ligji për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatieke dhe Konsullore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-125;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26 shkurt 2014;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi njëzëri procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 26 shkurt 2014.

3. Mbikëqyrja zbatimit të Ligji për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-125;

Albin Kurti theksoi se sipas Planit dhe programit të punës së Komisionit të këtij viti, është paraparë mbikëqyrja e zbatimit të Ligji për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-125. Ky ligj tha se është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 16 dhjetor 2008, është publikuar në Gazetën zyrtare nr. 46/2009, të datës 15 janar 2009 dhe parasheh nxjerrjen e një mori akteve nënligjore.

Pas diskutimeve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në fjalë, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-125, në përbërje të deputetëve: Enis Kervan, Emilija Rexhepi dhe Berat Buzhala.

4. Të ndryshme.

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me vizitën në Bruksel, që do të organizohet nga 6- 9 prill 2014.

Lidhur me ftesën që i është bërë ministrit Enver Hoxhaj, që të raportojë gjatë muajit mars, Komisioni pas njoftimit nga z. Hydajet Hyseni, për gatishmërinë e ministrit që të raportojë në Komision, vendosi që ministri të ftohet më datën 2 prill 2014.

Takimi përfundoi në orën 11:45.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti